

Konferenca kombëtare me temë: “Reforma në Qeverisjen Vendore dhe Administratën Publike – Mundësi të Reja për Administratën Vendore”

Në datën 3 Maj 2016, Këshilli i Europës në Shqipëri organizoi konferencën kombëtare me temë: “Reforma në Qeverisjen Vendore dhe Administratën Publike-Mundësi të Reja për Administratën Vendore”.

Në konferencë ishin të pranishëm përfaqësues dhe ekspertë të Këshillit të Europës në Tiranë, Ambasadori Zvicerian në Tiranë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Ministrja e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, përfaqësues të qeverisjes vendore, si dhe përfaqësues të institucioneve të pavarura.

Qëllimi i kësaj konference ishte prezantimi i arritjeve të realizuara në lidhje me reformën në administratën publike.

Gjatë kësaj konference, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Znj. Pranvera Strakosha bëri një prezantim të shkurtër të gjetjeve, problematikave dhe rekomandimeve të dhëna për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat janë pasqyruar edhe në Raportin Vjetor për vitin 2015, të paraqitur përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.



Znj. Strakosha u shpreh se: “Komisioneri po punon për të bërë të mundur krijimin e një sistemi të mbikëqyrjes dixhitale, efikas, dinamik, që ndjek në kohë reale çdo ndryshim apo lëvizje, çdo vlerësim apo procedim disiplinor në lidhje me nëpunësin civil. Ku të jenë të standardizuara konform ligjit dhe akteve nënligjore nxjerrë në bazë e për zbatim të tij, procedurat që duhet të ndjekin institucionet (njësia përgjegjëse) për të gjitha institutet e ligjit. Në përfundim Znj. Strakosha theksoi faktin se: “Komisioneri vlerëson respektimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe monitorimin e tij, të cilët janë aspekte thelbësore që sigurojnë suksesin e reformës në shërbimin civil, si pjesë e rëndësishme e reformës së administratës publike. Sfida e Komisionerit mbetet që të sigurojë një proces të pavarur dhe

efikas mbikëqyrjeje, me qëllim që të parandalojë shkeljen e ligjit dhe të rregullojë paligjshmërinë në rastet kur ka ndodhur, nëpërmjet mjeteve që i ka dhënë ligji”.

Konferenca u mbyll me premtimet e përfaqësuesve të Këshillit të Europës dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim për t’u angazhuar në mbështetje të qeverisë shqiptare për një qeverisje më efektive në nivel vendor.